



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:160847

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05471453

P.nr.175/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykses Ali Kutllovci, me antarë Xhemajl Jusufi dhe Leart Rexhaj me procesmbajsen Shukrije Selimi, në çështjen penale kundër të pandehures L.D, i akuzuar për veprën penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PPI.nr.93/22 të dt.16.10.2023. Me 01.03.2024, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në prezencën të pandehurit dhe mbrojtësit të tijë dhe prokuroit të shtetit në PTH në Mitrovicë Sahit Tmava, Gjykata me dt. 01.03.2024 ka shpallur publikisht aktgjykimin, ndërsa me dt.19.03.2024, ka përpiluar me shkrim këtë :

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuares:

L.D, nga i ati L...., e ëma M..., “data e lindjes”, në Prishtinë me vendbanim ne Z... P..., rruga “R... B...” nr..., e martuar, nene e tre femijve, ka kryer falultetin e gjeografis, serbe, shtetas i Republikës së Kosovës me numer personal, i gjendjes së mesme ekonomike , ndajsaj nuk zhvillohet procedur tjetër penale, e pa dënuar me parë.

SHPALLET FAJTORE

Sepse:

Me dt. 06.10.2019 rreth ores 19.00 në fshatin C..... –Zubin Potok saksisht në shkollen fillore “J.... C....”e pandehura L.D në qendren e votimit ...B gjatë mbajtjes së zgjedhjeve të parakoshme për kuvendin e Republokës së Kosovës me dt. 06.10.2019 në cilësin e Kryesuesit të vednvotimit me numer ...B /...D, duke keqperdor pozitën, detyrën apo autorizimet e tij lidhur me zgjedhjet pas mbylljes së vendvotimit të cekur si më lartë ka shtuar dhe hequr votat kandidatve brenda subjekteve politike gjatë numrimit të tyre në atë mënyrë mënyer duke i hequr votat e disa

kandidatve dhe duke i shtuar votat disa kandidatve tjerë, i regjistruar në mënyrë të pasaktë dhe atë; gjithsej 283 vota prej tyre 4 vota të shtuara dhe 279 vota të hequra, dhe atë të shtuara SL 4 vota, ndërsa të hequra SL 279 vota

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale: Falsifikim rezultateve të votimit nga neni 216 par 2 të KPRK-së

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72 par 1 nen 1.3 dhe neni 216 par 2 të KPRK-së, e lidhur me nenet 364 dhe 365 të KPP-së, të pandehures, i;

S H Q I P T O N

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, me kusht që e pandehura brenda periudhës kohore prej 2 (dy) vite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë penale të natyrës së njëjtë apo të natyrës më të rëndë.

E pandehura obligohet të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, si dhe shumë prej 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej 70 (shtatëdhjetë) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PPI.nr.93/22 të dt.16.10.2023, në Gjykatën Themelore Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të rënda, ndaj të pandehures: L.D, i akuzuar për veprën penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK

Rrjedha e procedurës penale

Kryetari i trupit gjykues me dt.15.12.2023, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca ishte mbajtur në prezencën e palëve: Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë Sahit Tmava dhe të pandehures e cila nuk e ka pranuar fajsin lidhur me veprën penale që i vihet në barrë.

Mbrojtësi i të pandehurit brenda afatit ligjor ka paraqitur kundërshtimin e provave dhe propozimin për hudhjen e aktakuzës.

Kryetari i trupit gjykues me aktvednimin Pnr.175/23 dt.19.01.2024 e ka refuzuar si të pabazuar kundërshtimin e provave dhe propozimin për hudhjen e aktakuzës.

Mbrojtësi i të pandehurit nuk ka parashtruar ankesë kundër aktvednimit për refuzimin e kundërshtimit dhe hudhjen e aktakuzës.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, Departamenti për krime të rënda, në këtë çështje penale, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me dt.01.03.2024, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar prokurori i shtetit Sahit Tmava, e akuzuara , mbrojtësi i saj av. Nebojsa Vllaiç

Në shqyrtim gjyqësor pasi që gjykata të akuzuarin e njoftoj me pasojat dhe beneficionet që parashihen me ligj e të cilat kanë të bëjnë lidhur me pranimin e fajësisë nga e akuzuara në shqyrtim gjyqësor, e akuzuara pas konsultimit edhe me mbrojtësin e saj u deklarua se e pranon fajsin ashtu siq përshkruhet në aktakuzë.

Gjykata, ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehures dhe nga prokurori i rastit , i cili i ka propozuar gjykatës, që këtë pranim të fajësisë të deklaruar nga e pandehura ta pranojë gjykata si të bazuar, pasi që e njëjta ka mbështetje edhe në provat-shkresat e kësaj lënde penale.

Gjetjet e gjykatës

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar e pandehura , e në mbështetje të nenit 322 dhe neneit 242 par.2 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehures mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë:Libri i votimit/kopje/ për vendvotimin Nr....B/...D, formulari /kopje/ i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve e krijuar ne vendvotimin Nr....B/...D të rinumrimit në QNR,/kopje/ formulari /kopje/ i përputhjes se të dhënave, rezultateve të kandidatve /FRK/ e krijuar ne vendvotimin nr. Nr....B/...D dhe FRK e rinumruar ne QNR /kopje/ tabela /ne exel/ e specifikuar me emrin e kandidatit subjektin politik dhe pasqyra e votave të numruara në vendvotim dhe rezultati pas rinumrimit ne QNR / vota të cilat janë shtuar apo hequr ne detaje/ , deklarata e të pandehuroit si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova gjykata i vlerëson / por pa i administruar sepse e pandehura e ka pranuar fajsin ne shqyrtimin fillestar/ si prova relevante , të besueshme dhe me fuqi provuese për elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale dhe të njëjtat janë konsistente dhe janë bindëse për gjykatën dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese e që në bazë të tyre dhe

pranimi të fajësisë nga ana e të pandehures, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i njëjti ka kryer veprën penale: Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 216 par.2 të KPRK

Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehures është bërë në mënyrë vullnetare, se ajo e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë.

Gjykata i kishte tërhequr vërejtjen të pandehures se pas pranimi të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, er njëjta është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësin e kundërshtimit te provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave të tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë prej të pandehures dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimit ka vërtetuar se e pandehura , para së gjithash është e përgjegjshme dhe përgjegjëse (fajtores) për veprën penale për të cilën akuzohet.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit Sahit Tmava në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.01.03.2024, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: nga provat e renditura në aktakuz pastaj edhe nga vet prnaimi i fajsis nga e pandehura provohet se e njejta ka kryer veprën penale.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Nebojasha Vllaç, në fjalën përfundimtare deklaron: e dimë se pranimi i fajsis është rrethanë letsuese dhe dua të shtoj se kjo veper penale nuk ka pasur pasoja të dëmshme dhe nuk e ka ndryshuar rezultantin e zgjedhjeve , e pandehura është person familjare dhe I propozoi gjykates ti shqiptoj një denim te bute dhe mundëshisht me kushtë.

E akuzuara L.D në fjalën përfundimtare deklaron se pajtohet me fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i saj .

Analiza e rrethanave për matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata me rastin e matjes së denimit, në përputhje me nenin 69 të KPRK-së për arritjen e qëllimit të denimit nga neni 38 të KPRK-së e duke analizuar secilën rrethanë veç e veç nga neni 69 , për rregullat – parimet e përgjithshme për matjen e denimit / e duke patur kujdes për rrezikun

e dyfishimit të llogaritjes së rrehanve sepse disa prej rrethanave të përcaktuara në këtë dispozit pasqyrojnë në një mënyrë elementet e figurës së veprës penale/ dhe atë; Shkallën e përgjegjësis penale – ashtu që lidhur me këtë rrethanë gjykata gjenë se e pandehura është e përgjegjshme dhe përgjegjëse se e pandehura ishte e aftë ti kuptoj rëndësin e veprimeve të saja dhe e aftë ti kontrolloj veprimet e saj, e vetëdijshme për veprimet e saj e duke e pranuar kryerjen e saj (dashje eventuale) ,(pra nënshkrimin e formularit edhe pa verifikimin dhe percjelljen e punës së antarve tjer të vendvotimit) , duke qen e vetëdijshme se veprimi i sajë është i ndaluar me ligj me dashje eventuale ka ndermarr veprimet inkriminuese , kjo i atribuohet si rrethanë rënduese. Lidhur me rrethanat në të cilat është kryer vepra penale - e pandehura me vetëdije rezulton e ka neglizhuar rolin e pozicionit te sajë si kryesuese dhe me qëllim ka lejuar dhe ka nënshkruar formularin , kjo merret si rrethnë renduese.

Lidhur me sjelljen e mëparshme të kryersës , gjykata gjenë se e pandehura që nga rinia duke vijuar shkollën – fakultetin e Gjeografisë ,por në të njëjtën kohë , i orjentuar për ta ndihmuar , të gjitha këto rrethana i japin nje epitete te ‘*Karakterit të mire*’ e që gjykata e merr si shumë relevant me rastin e matjes së denimit sepse kjo trgon se sjellja kriminale nuk është pjesë e sjelljeve të zakonshme të të pandehures, këta factor ndikojnë në vlersimin e rrethanave sepse nderlidhen me reputacionin, kredibilitetin dhe personalitetin dhe sjelljen shoqërore të të pandehures , që tregojnë se vepra e kryer është jashtë karakterit të sajë , andaj krejt kjo paraqitet si **rrethanë lehtësuese** në përcaktimin e llojit dhe në matjen e denimit . Bazuar në rrethanat personale të kryersit e që lidhen me gjendjen persoanale dhe familjare , në veçanti fakti se I njejti jeton me burrin dhe tre fëmijët e saj , vlersohet si një rrethanë letsuese për të pandehuren. Pastaj, sjellja e sajë pas kryerjes së veprës penale – del se ka qenë shumë kooperative.

Lidhur me pranimin e fajsis – gjykata gjenë se e pandehura e pranon fajsin , kjo tregon bindjen e saj se i ka kuptuar veprimet e saja , ka kuptuar rëndësin e veprimeve të saja , sjelljen e saj e rolin e sajë në këtë rast , e këtë e materjalizon në tërsi me pranimin e fajsisë për veprën penale e që kjo është rrethanë ligjore për një denim më të butë. Por , kjo rrethanë e shprehur ne këtë mënyrë domosdo duhet pranuar dhe të merret edhe nga gjykata si rrethanë letsuese. Ndërsa lidhur me rrethanat që kanë të bëjnë më personalitetin e kryesit – të gjitha rrethanat tregojnë se e pandehura shpejt e ka kuptuar se veprimet e saja jane në kundërshtim me ligjin dhe se është penduar thellë shumë shpejt se në suaza të këtij premtimi premtion vazhdimisht se nuk do të kryej më veprime te tilla por edhe rrethant e elaboruar amë lartë.

Në suaza të analizimit të këtyre rrethanave *një nga një* për individualizimin e denimit si kërkesë ligjore për matjen e denimit dhe llojin e denimit, gjykata gjenë se *mbipeshojnë rrethanat lehtsuese* të përcaktuara në nenin 70 lidhur me nenin 71 par 1 nenp 1.3 e lidhur me nenin 72 par 1 nën par 1.3 të KPRK-

Për më tepër, gjykata e kushtëzoi dënimin me burgim që të mos ekzekutohet, sepse e pandehura me një gjendje jo të mirë ekonomike dhe është i vetmi person që kujdeset për familjen dhe fëmijët dhe vlen të ceket se njëri nga fëmijët don përkujdeje të veçant për shkak të problemeve shëndetsore dhe ekzekutimi eventual i dënimit do të vështërsonte jetën dhe familja e tij do të mbetej pa përkujdesje në këtë rast e sidomos fëmija me problem shëndetsore.

Gjykata vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehures, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehures dhe rrethanat e tjera që i kemi cekur më lartë është adekuat dhe ne si gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehuren por edhe në raport me personat e tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-ës.

Nga ajo që u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.175/2023 të datës 19.03.2024

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Ali Kutllovci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.